REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2128/5 Prot. Pukë, më 04.12 .2024

# PROCESVERBAL I MBLEDHJES Së KËSHILLIT BASHKIAK PUKË

## Date 03.12 .2024

Në mbështetje të ligjit nr.**139/2015**, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim te vendimit të kryesisë së këshillit nr. 4 datë 14.11.2024, mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Pukë do te zhvillohej me datën **27 .11.2024** ,ora **13-⁰⁰** tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite: por per aresye mospjesemarrje u anullua dhe u ra dakord nga te pranishmit , qe te zhvillohet me date 03.12.2024, ora 13:00 tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me te njejtin rend - dite:

**1.** Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 16.10.2024

**2.** Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shtator 2024**.

**3.** Projekt vendim : Per rishqyrtimin e pikës 1 dhe 8 të VKB nr. 47 datë 16.10.2024 " Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Pukë për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare së bashku me dokumentacion tekniko-ligjor për familjen e z. Ardian Keci , banesa e të cilit është dëmtuar nga renie zjarri( djegie), nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile dhe fondi i emergjencave civile, buxheti i Bashkisë Pukë"

**4.** Projekt - vendim " Për një shtesë në VKB nr 6 date datë 09. 02.2024 " Për miratimin e dhënies në përdorim nga fondi pyjor të një siperfaqe pyjore publike prej 6.65 Ha në ekonominë pyjore Kryezi –Bicaj për ndërtim kanali dhe shtrirje tubacioni uji nga subjekti "Uji Puka"

**5.**Projekt Vendim " Për dhënie në përdorim me afat 10 vjet, siperfaqe pyjore prej 11 Ha për qellime pushimi, argëtimi, shëndetesore, turistike, sportive dhe kulturore" në parcelën, nr. 93/a dhe 101/a të ekonomisë pyjore Krrab-Bushat"

**6.** Projekt-vendim " Për miratimin e planit të mbarshtimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe në NJA Qerret, Pukë, të Bashkisë Pukë"

**7.** Projekt-vendim " Për procedurat e prioriteteve për investime e shërbime për vitin 2025"

**8.** Projekt-Vendim : " Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Pukë për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare së bashku me dokumentacion tekniko-ligjor për familjen e z. Mhill Tom Mhilli , banesa e të cilit është dëmtuar nga fatkeqesi natyrore , rreshqitje e dherave( shembje e murit te shtepise) nga fondi i emergjencave civile, buxheti i Bashkisë Pukë"

**9.** Projekt-vendim : "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Pukë për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare së bashku me dokumentacion tekniko-ligjor për familjen e zj. Shaqe Permarkaj , banesa e të ciles është dëmtuar nga fatkeqesi natyrore ( shembje e murit te shtepise) nga fondi i emergjencave civile, buxheti i Bashkisë Pukë"

**10.** Projekt-vendim : Vleresim me tituj nderi.

**11.** Projekt-vendim: **"Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Pukë për vitin 2025"**

**12.** Informacion i keshillit te Bashkise per doreheqjen e kryetarit te fshatit Uksth dhe zgjedhjen e kryetarit te ketij fshati.

**13.** Të tjera.

Ne mbledhje moren pjese: , Kryetari i bashkisë Rrok Dodaj, Lavdie Tërbuni, Behar Aleni, Fatlinda Hyseni, Edmond Prendi, Ferit Kringaj Zv/kryetar, Altin Përdeda Zv/kryetar,

Mbledhja filloi ne oren 13.10 siç ishte njoftuar. Jane prezent ne mbledhje 9 (nëntë) keshilltarë , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes.

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit te Bashkise z. Gjon Gjoka., i cili hodhi ne votim rendin e dites , qe u miratua me 9 vota pro. duke hequr pikën 4 dhe 5 të rendit të ditës. Për mungesë dokumentacioni

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 16.10.2024: Ne vijim u hodh ne votim procesverbali i mbledhjes se keshillit te dates 16.10 .2024 dhe u miratua me 9 vota pro.

2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shtator 2024**. Me pas u diskutua dhe u hodh ne votim projekt- vendimi per miratimin e ndihmes ekonomike , duke perdorur deri ne 6% te buxhetit. **U miratua ndihma per muajin Shtator 2024 me** 9 **vota pro.**

3. Projekt vendim : Per rishqyrtimin e pikës 1 dhe 8 të VKB nr. 47 datë 16.10.2024 " Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Pukë për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare së bashku me dokumentacion tekniko-ligjor për familjen e z. Ardian Keci , banesa e të cilit

është dëmtuar nga renie zjarri( djegie), nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile dhe fondi i emergjencave civile, buxheti i Bashkisë Pukë"

Sqaron Behar Ademi : Është paragjykuar në mbledhjen e kaluar dhe po rishqyrtohet sepse kishte një paqartësi.

Pyetje: Sa është parashikuar mbi kuota?

Diskutime :

U hodh ne votim dhe ~~nuk~~ / **u miratua me** [illegible] **vota pro.**

4. Projekt - vendim " Për një shtesë në VKB nr 6 date datë 09. 02.2024 " Për miratimin e dhënies në përdorim nga fondi pyjor të një siperfaqe pyjore publike prej 6.65 Ha në ekonominë pyjore Kryezi –Bicaj për ndërtim kanali dhe shtrirje tubacioni uji nga subjekti "Uji Puka"

Është hequr nga rendi i ditës në fillim të mbledhjes

Pyetje :

Sqaron Edmond Prendi :

Diskutime :

U hodh ne votim dhe nuk/ u **miratua me __________ vota pro. Vota kunder ______ dhe vota abstenim____**

**Keshilltaret qe votuan kunder:**

**Shpjegim vote :**

5. Projekt Vendim " Për dhënie në përdorim me afat 10 vjet, siperfaqe pyjore prej 11 Ha për qellime pushimi, argëtimi, shëndetesore, turistike, sportive dhe kulturore" në parcelën, nr. 93/a dhe 101/a të ekonomisë pyjore Krrab-Bushat"

Pyetje :

Eshtë heq nga rendi i ditës në fillim të mbledhjes -

Sqaron Edmond Prendi:

Diskutime:

Hidhet ne vote dhe nuk/ u **miratua me _____ vota pro , _____ vota kunder, dhe _______ vota abstenim**

Keshilltaret qe votuan kunder:

Shpjegimi i votes kunder:

6. Projekt-vendim " Për miratimin e planit të mbarshtimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe në NJA Qerret, Pukë, të Bashkisë Pukë"

Pyetje : –

Sqaron : Edmond Prendi : Plani është për një periudhë 10 vjeçare dhe aktivitet për këtë periudhë dhe ndërhyrjet e nevojshme. Mbi një shtrirje në dy njësi vendore Qerret dhe Pukë.

Diskutime : –

**U hodh ne votim dhe nuk/u miratua me** 9 **pro,** – **vota kunder ,** – **vota abstenim.**

Keshilltaret qe votuan kunder :

Shpjegimi i votes kunder: –

7. Projekt-vendim " Për procedurat e prioriteteve për investime e shërbime për vitin 2025"

Pyetje: - Cilët pallate përfshihen në rikonstruksionin e pallateve të hyrjes së qytetit.

Sqaron : Lindita Hyseni : Mund të shtohen edhe prioritete të tjera. Prioritet, derisa të realizohen mbetet në listë. Mrena aplikuar për të realizuar. Ne kemi menduar të jenë 9 pallate propozimi është bërë për 11 blloqe

Diskutime : Është harruar ura e Mçthit.

Besmira Alia: Pse nuk është realizuar ndriçimi i Bajrës Kulaj.

Prek Dedaj: Është si hartimi i planit të menaxhimit. Ne morëm iniciativë pa patur fonde dhe u hartua plani i menaxhimit të pyjeve

U hodh ne votim dhe nuk / u **miratua me** 12 **vota pro,** - = **vota kunder,** = **vota abstenim .**

**Keshilltaret qe votuan kunder:**

**Shpjegimi i votes kunder:**

8. Projekt-Vendim : " Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Pukë për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare së bashku me dokumentacion tekniko-ligjor për familjen e z. Mhill Tom Mhilli , banesa e të cilit është dëmtuar nga fatkeqesi natyrore , rreshqitje e dherave( shembje e murit te shtepise) nga fondi i emergjencave civile, buxheti i Bashkisë Pukë"

Pyetje :

Sqaron : Behar Ademi : Pas kërkesës së M.T.M. është ngritur grupi i punës, zona e Gdheshës ka shumë rrëshqitje dherash. Ka vetëm probleme të banesës kryesisht nga rrëshqitja e dherave

Rikat I (përsëritje i faqes paraardhëse)

Rrok Dodaj: vazhdim i faqes paraardhëse

→ do të realizohen rikonstruksioni i të gjitha blloqeve të pallateve

→ Rikonstruksioni i tregut

→ Rivitalizimi i liqenit pastaj dhe elementë të tjerë.

→ Enver Sulejmani: Pse janë tërhequr shelgjet? (nuk po punohet.)

Rrok Dodaj: Për efekt të kohës është më i përshtatshëm rikonstruksioni i pallateve.

→ Kemi punuar me problemin e varrezave të qytetit të Pukës.

Ne kemi gjetë disa mundësi dhe do të vendosim vendin të cilën e kemi ku është në... Derrati sqbimi. Një pikë është në [illegible] dhe do të bëjmë për [illegible]

– Arben Gugaj: Reshjet i kanë prish rrugët në [illegible], duhet ndërhyrje.

Rrok Dodaj: Reshjet kanë bërë shumë dëmtime, kemi ngrit grupet e punës për verifikimin e dëmeve të bëjmë ndërhyrje me mjetet tona dhe të biznesit. Ne po bëjmë përpjekje maksimale.

Diskutime :

Hidhet ne votim dhe ~~nuk~~ / u **miratua me** 10 **vota pro,** – **vota kunder,** – **vota abstenim .**

**Keshilltaret qe votuan kunder:**

**Shpjegimi i votes kunder:**

9. Projekt-vendim : "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Pukë për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare së bashku me dokumentacion tekniko-ligjor për familjen e zj. Shaqe Permarkaj , banesa e të ciles është dëmtuar nga fatkeqesi natyrore ( shembje e murit te shtepise) nga fondi i emergjencave civile, buxheti i Bashkisë Pukë"

Pyetje :

Sqaron : Behar Ademi Është shëmbur muri i shtëpisë në Njësinë administrative Qelëz.

Diskutime :

Hidhet ne votim dhe ~~nuk~~ / u **miratua me** 10 **vota pro,** — **vota kunder,** — **vota abstenim .**

**Keshilltaret qe votuan kunder:**

**Shpjegimi i votes kunder:**

10. Projekt-vendim : Vleresim me tituj nderi. Propozim per dhenie titulli " Qytetar Nderi i Bashkise Puke" Z. Ndrek Zaja , propozuar nga Keshilltaret : Besmira Aliaj dhe Edmond Luka , te cilet sqarojne keshillinin per kete propozim: Arësyet janë shkruar në propozim.

Miratohet me 10 vota pro.

11. Projekt-vendim: **"Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Pukë për vitin 2025"**

**Pyetje :**

**Sqaron z. Gjon Gjokaj:** Jepi të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet përkatëse, për secilin aktivitet dhe pagat, shpenzimet e të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave

**Diskutime :** s'ka

Miratohet me 10 vota pro

12. Informim i keshillit te Bashkise per doreheqjen e kryetarit te fshatit Ukth dhe zgjedhjen e kryetarit te ri te ketij fshati.

Shpjegon aresyet e doreheqjes z. Alban Lleshi: Alban Lleshi është dorëhequr, sepse është anëtar i këshillit, janë bërë procedurat e zgjedhjes

Sqarojne keshillin keshilltaret qe kane ndjekur proceduren : së anëtarit të kryesisë dhe të kryetarit të fshatit. Përfaqësues e këshillit kanë asistuar procesin.

13. Te tjera : U prezantuan disa kërkesa drejtuar këshillit, por do të shqyrtohen në mbledhjet në vijim.

ALFONS GJERGJAJ

Edmond Culaj

Besmira Aliaj

Aleksander Frroku

Alban Lleshi

Shpresa Pemaj

Sekretari i këshillit